



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 120

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 15 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 6.6.2024	Çështja Ylli Pinari kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 32893/16)..... 14351
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 6.6.2024	Çështjet Arben Kallo kundër Shqipërisë dhe Ledjo Yzeiri kundër Shqipërisë (kërkesat nr. 29273/16 dhe 2398/18)..... 14352
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 6.6.2024	Çështjet Tahir Çuni kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 37935/18) dhe 2 kërkesa të tjera..... 14353
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 11.6.2024	Çështja Kalemi kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 59222/15)..... 14354
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 11.6.2024	Çështja Zela kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 33164/11)..... 14357

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 32893/16

Ylli PINARI

kundër Shqipërisë

(shihni tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 maj 2024 si
Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *president*,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në
detyrë e Seksionit*,duke pasur parasysh kërkesën më sipër të
depozituar më 1 qershor 2016,duke pasur parasysh deklaratat formale për
pranimin e zgjidhjes miqësore të çështjes,
pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesit jepen në tabelën bashkë-
ngjitur.Kërkuesi u përfaqësua nga z. M. Gjoçi, avokat i
licencuar në Tiranë.

Qeverisë shqiptare (“Qeveria”) iu komunikua
ankimi i kërkesit sipas paragrafit 1 të nenit 6 të
Konventës, në lidhje me të drejtën e tij për t’iu
drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe mungesën e
paanshmërisë së gjyqtarit të asaj gjykate.

Gjykata mori deklaratat për zgjidhjen miqësore të
nënshkruara nga palët, sipas të cilave kërkesi pranoi
të hiqte dorë nga çdo pretendim tjetër kundër

Shqipërisë, në lidhje me faktet që çuan në këtë
kërkese, me kushtin që Qeveria të merrte përsipër t’i
paguante atij shumën e detajuar në tabelën
bashkëngjitur. Kjo shumë do të konvertohet në
monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit
të datës së pagesës dhe do të paguhet brenda tre
muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës.
Në rast të mospagimit të kësaj shume brenda
periudhës së lartpërmendur tremujore, Qeveria merr
përsipër të paguajë një kamatëvonesë të thjeshtë nga
momenti i mbarimit të kësaj periudhe deri në
momentin e shlyerjes, me një normë të barabartë me
normën e huadhënies marxhinale të Bankës
Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit
plus tre pikë përqindjeje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të
çështjes.

LEGJISLACIONI

Gjykata mban parasysh zgjidhjen miqësore të
arritur ndërmjet palëve. Ajo është e bindur që
zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të
njeriut të përcaktuara në Konventë dhe në
Protokollet e saj dhe nuk gjen arsye për të justifikuar
shqyrtimin e kërkesës në vazhdim.

Nisur nga sa më lart, është me vend që çështja të
çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,
vendos të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e
çështjeve në përputhje me nenin 39 të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim
më 6 qershor 2024.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE
NË DETYRË

Peeter Roosma
PRESIDENT

SHTOJCË

Kërkesa që paraqet ankimin sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës
(e drejta për gjykatë të paanshme dhe e drejta për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkesit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së deklaratës së kërkesit	Shuma e caktuar për dëm pasuror dhe jopasuror dhe kosto dhe shpenzime për kërkes (në euro) ¹
32893/16 01/06/2016	Ylli Pinari 1953	Gjoçi Mirgen Tiranë	2.4.2024	1.4.2024	5.600

¹ Plus çdo taksë që mund t’i ngarkohet kërkesit.



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesat nr. 29273/16 dhe 2398/18

Arben Kallo kundër Shqipërisë
dhe *Ledjo Yzeiri kundër Shqipërisë*
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 maj 2024 si një
Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësekretare e*
Seksionit e Përkohshme,

duke mbajtur në konsideratë kërkesën e
mësipërme të depozituar më 22 maj 2020;

duke mbajtur në konsideratë kërkesat e
mësipërme të depozituara në data të ndryshme
paraqitur në tabelën bashkëlidhur;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkuessve paraqitet në shtojcë.

Ankesat e kërkuessve në lidhje me aspekte të
ndryshme të gjykimit në mungesë dhe procedurat
civile, të tilla si kohëzgjatja dhe kushtet e ndalimit
sipas neneve 3 dhe 6 të Konventës, iu komunikuan
qeverisë shqiptare, e cila bëri parashtrime mbi
pranueshmërinë dhe meritat.

Parashtrimet iu dërguan kërkuessve, të cilët u
ftuan të dorëzonin parashtrimet e tyre.

Me anë të shkresave të dërguara me postë
rekomande, përfaqësuesit e kërkuessve dhe kërkuessit
u ftuan t'u përgjigjeshin shkresave të Gjykatës.
Vëmendja e kërkuessve u drejtua te neni 37 § 1 (a) i
Konventës, që parashikon se Gjykata mund të
përfshijë një kërkesë nga lista e saj e çështjeve,
nëse rrethanat çojnë në përfundimin se kërkuessi nuk
ka për qëllim ta ndjekë kërkesën.

Megjithatë, në vijim nuk është dhënë asnjë
përgjigje.

LIGJI

Duke pasur në konsideratë lëndën e ngjashme të
kërkesave, Gjykata e vlerëson me vend që t'i
shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Mbështetur në sa më sipër, Gjykata arrin në
përfundimin se mund të konsiderohet se kërkuessit
nuk dëshirojnë të ndjekin më tej kërkesat (neni 37 §
1 (a) i Konventës). Gjithashtu, në mbështetje të
nenit 37 § 1 *in fine*, Gjykata nuk konstaton asnjë
rrethanë të veçantë në lidhje me respektimin e të
drejtave të njeriut, sipas përcaktimit në Konventë
dhe Protokolleve të saj, ku kërkohet shqyrtimi i
vazhduar i kërkesave.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

Deklaron bashkimin e kërkesave;

Vendos të përjashtojë kërkesat nga lista e saj e
çështjeve.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më
6 qershor 2024.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETAR
E E PËRKOHSHE

**Peeter
Roosma**
KRYETAR
R

SHTOJCË

Lista e kërkesave me anë të të cilave paraqiten ankesa, sipas neneve 3 dhe 6 të Konventës.

Nr.	Numri i kërkesës Data e paraqitjes	Emri i kërkuessit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e shkresës së regjistruar të Gjykatës
1	29273/16 26.4.2016	Arben Kallo 1971	Thimjo Kondi Tiranë	5.12.2023 20.2.2024 (shpallur më 22.3.2024)
2	2398/18 5.1.2018	Ledjo Yzeiri 1975	Elton Lula Tiranë	18.1.2024 (shpallur më 31.1.2024)

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË
NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

KËRKESA NR. 37935/18
TAHIR ÇUNI KUNDËR SHQIPËRISË
DHE 2 KËRKESA TË TJERA
(Shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 maj 2024 si një
Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *Kryetar,*

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktorya Maradudina, *zëvendëssekretare e*

Seksionit e Përkohshme,

Duke mbajtur në konsideratë kërkesat e
mësipërme të depozituara në data të ndryshme të
paraqitura në tabelën bashkëlidhur,

Duke mbajtur në konsideratë deklaratat formale
me anë të të cilave pranohej një zgjidhje miqësore e
çështjeve

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkuessve paraqitet në shtojcë.

Ankesat e kërkuessve në mbështetje të nenit 6 § 1
të Konventës në lidhje me moszbatimin ose
zbatimin e vonuar të vendimeve vendëse iu
komunikuan Qeverisë shqiptare (“Qeveria”). Në
disa prej kërkesave, ankesat e mbështetura në të
njëjtat fakte u komunikuan sipas parashikimeve të
tjera të Konventës.

Gjykata mori deklaratat për zgjidhje miqësore të
nënshkruara nga palët, sipas së cilave kërkuessit binin
dakord që të hiqnin dorë nga kërkesa të tjera ndaj
Shqipërisë për faktet që ngrinin këto kërkesa, pas
marrjes përsipër nga Qeveria që t’i paguante atyre
shumat e detajuara në tabelën bashkëlidhur. Këto

shuma do të konvertohen në monedhën e Shtetit të
paditur në normën e zbatueshme në datën e
shlyerjes së shumave dhe do të paguhën brenda tre
muajve nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës.
Në rast se këto shuma nuk do të paguhën brenda
periudhës tremujore të përmendur më sipër,
Qeveria merr përsipër të paguajë interes të thjeshtë
ndaj shumave nga përfundimi i asaj periudhe deri në
shlyerje në një normë të barasvlershme me normën
marginale të huadhënies të Bankës Qendrore
Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre
pikë përqindje. Gjithashtu, Qeveria merr përsipër të
sigurojë zbatimin e vendimeve vendëse në çështjet
konkrete (shih tabelën bashkëlidhur) brenda të
njëjtës periudhë tremujore, si edhe të paguajë çdo
kosto për procedurat vendëse të zbatimit të
vendimeve.

Pagesa dhe zbatimi i vendimeve vendëse në
çështjet konkrete do të përbëjnë zgjidhjen
përfundimtare të çështjeve.

LIGJI

Duke pasur në konsideratë lëndën e ngjashme të
kërkesave, Gjykata e gjykon me vend t’i shqyrtojë
ato së bashku në një vendim të vetëm.

Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore
të arritur midis palëve. Ajo është siguruar se zgjidhja
mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut
sipas parashikimit në Konventë dhe protokolleve të
saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar
shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesave.

Mbështetur në sa më sipër, është me vend që
çështjet të përjashtohen nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos të bashkojë kërkesat;

Vendos të përjashtojë kërkesat nga lista e saj e
çështjeve sipas nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më
6 qershor 2024.

Viktorya Maradudina
Zëvendëssekretare e
përkohshme

Peeter Roosma
Kryetar



SHTOJCË

*Lista e kërkesave me anë të të cilave paraqiten ankesa sipas nenit 6 § 1 të Konventës
(moszbatimi ose zbatimi i vonuar i vendimeve vendëse)*

Nr.	Numri i kërkesës Data e paraqitjes	Emri i kërkesit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së deklaratës së kërkesit	Shuma e akorduar për dëmin jo pasuror për kërkes (në euro) ²	Shuma e akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkesë (në euro) ³
1	37935/18 3.8.2018	Tahir ÇUNI 1953		Neni 13 – mungesa e mjeteve efektive në ligjin vendës për moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve vendëse	15.9.2023	17.8.2023	3,600	-
2	1921/19 7.1.2019	Ilirjan PROKO	Gumi Viktor Tiranë		15.9.2023	29.8.2023	3,600	250
3	44307/21 1.12.2021	Durim GRABOVA 1951			15.9.2023	5.5.2023	1,200	-

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

*Çështja kalemi kundër Shqipërisë
(kërkesa nr. 59222/15)*

VENDIM

STRASBURG

11 qershor 2024

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen **Kalemi kundër Shqipërisë**,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar*,

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*dhe Olga Chernishova, *zëvendësekretare e Seksionit*, duke pasur në konsideratë:

kërkesën (nr. 59222/15) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 26 nëntor 2015 nga tre shtetas shqiptarë, detajet e të cilëve janë listuar në tabelën bashkëlidhur (“kërkesit”), të përfaqësuar nga znj. S. Mëneri, një avokate e cila e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për t’i njoftuar kërkesën qeverisë shqiptare (“Qeveria”), e përfaqësuar nga znj. B. Lilo,

dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
vërejtjet e palëve;
pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 21 maj 2024,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesit zotëronin bashkërisht 1,031 metër katrorë tokë. Në vitin 2010, Bashkia e Durrësit autorizoi asfaltimin e një rruge publike që shtrihej në një pjesë të asaj toke (622 metër katrorë). Kjo detyrë u përfundua nga një kompani private. Duke iu referuar, ndër të tjera, neneve 199–203 të Kodit Civil, kërkesit e parë dhe të dytë i kaluan procedurat në Gjykatën e Rrethit Durrës. Me anë të vendimit të datës 21 shtator 2011, kjo gjykatë urdhëroi bashkinë dhe kompaninë që të lironin dhe t’i kthenit paditësve (kërkesit e parë dhe të dytë) parcelën, të hiqnin të gjitha ndryshimet e bëra në të dhe ta rikthenin në gjendjen e saj funksionale fillestare. Më 30 qershor 2014, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin. Në tetor 2014 u lëshua një urdhër-ekzekutimi.

2. Rezulton se palët e tjera private, në atë periudhë të ndryshme kohore, kishin ngritur ndërtesa në trotuare, duke cenuar pjesë të tjera të tokës së kërkesve. Rezulton se kërkesit nuk paraqitën ndonjë pretendim për këtë aspekt në ndonjë gjykatë.

3. Kërkesit depozituan ankesa në mbështetje të nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1

² Plus çdo taksë që mund t’u tarifohet kërkesve.

³ Plus çdo taksë që mund t’u tarifohet kërkesve.



të Konventës, së bashku me nenin 13 të Konventës, për moszbatimin e vendimit të përmendur më sipër.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 TË KONVENTËS DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

A. Fusha e veprimit e ankesave

4. Fusha e veprimit e një çështjeje, referuar në Gjykatë në ushtrim të së drejtës për kërkesë individuale përcaktohet nga “ankesa” e kërkuarit ose “padi” (shih *Grosam kundër Republikës së Çekisë* [DHM], nr. 19750/13, § 51, 1 qershor 2023, dhe *Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë*, nr. 29943/18, §§ 75, dhe 79, 4 prill 2023). Në çështjen konkrete, ankesat e paraqitura në formularin e kërkesës nga avokati i kërkuarve në nëntor 2015 kishte të bënte me pretendimin për shkelje të nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për moszbatimin në atë periudhë të vendimit të datës 21 shtator 2011, që ishte lënë në fuqi dhe ishte bërë i formës së prerë më 30 qershor 2014. Në këtë mënyrë, pretendimet kishin të bënin periudhën pas asaj date, më konkretisht pas lëshimit të urdhër-ekzekutimit në tetor 2014.

5. Nuk u ngritën pyetje për faktin se vendimi mbeti në fuqi për sa i përket rikthimit efektivisht të kapacitetit të kërkuarve për të rimarrë në pronësi dhe për të përdorur token e tyre. Në parashtrimet e bëra më 2021–2023, kërkuarit pretenduan, sidoqoftë, se tashmë nuk ekzistonte më një perspektivë realiste për të pasur sukses në përfitimin nga ai vendim. Ata iu referuan periudhës së papërcaktuar, pasi kishin depozituar kërkesën konkrete pranë Gjykatës në nëntor 2015, si edhe ndërtimeve të ndryshme të autorizuar dhe të ngritura rreth zonës së shtruar me trotuar, duke përfshirë periudhën përpara datës 1 qershor 2014, kur vendimi u bë i formës së prerë. Sidoqoftë, vërehet se as kërkuarit dhe as debitori/ët në vendim dhe as ndonjë autoritet publik kompetent nuk përfitonin ndonjë formë zëvendësuese për metodën e zbatimit të përcaktuar në vendim. Gjithashtu, asnjë nga gjykatat nuk vendosnin se në një pikë të caktuar vendimi ishte bërë i moszbatueshëm. Kjo gjë nuk është mënjeluar dhe mbetet në fuqi (shih *Voronkov kundër Rusisë*, nr. 39678/03, § 36, 30 korrik 2015, dhe çështjet e cituara në këtë vendim). Kërkuarit vijojnë të kenë titullin e pronësisë ndaj tokës në fjalë. Në këtë mënyrë, Gjykata do të procedojë mbi prezumimin, se vendimi mund të ishte zbatuar sipas

urdhrit, në periudhën nga muaji tetor 2014 dhe nëntor 2015, dhe në vijim.

6. Gjithashtu, pas komunikimit të ankesave pranë Qeverisë së paditur, më 2021–2023, kërkuarit parashtruan, se ata: i. ishin bërë viktima të një “shpronësimi *de facto*”, që kishte ndikuar negativisht në kapacitetin e tyre për të ushtruar pronësinë e tyre ndaj asaj toke, për shembull, duke e transferuar titullin e pronësisë të palë të tjera me anë të shitjes ose një transaksioni tjetër; dhe ii. kishin pësuar dëmtime të tjera në lidhje me vlerën e tregut të pronës së tyre. Gjykata konstaton, së pari, se parashtrimet synonin të vërtetonin pretendimin e tyre për kompensim të drejtë sipas nenit 41 të Konventës, në lidhje me ankesat fillestare (shih paragrafin 4 më sipër dhe paragrafin 16 më poshtë). Së dyti, për sa i përket ankesës së veçantë të kërkuarve për kufizimet ndaj të drejtave të tyre ndaj pronës, kjo gjë nuk është një shtjellim i ankesave të bëra në vitin 2015, dhe është jashtë fushës së veprimit të çështjes konkrete, që iu komunikua Qeverisë së paditur në vitin 2021. Asgjë nuk i ndalonte kërkuarit që të ndryshonin në mënyrë të menjëhershme, në periudhën midis vitit 2015 dhe 2021, kërkesën e tyre që ishte pezull në Gjykatë, në lidhje me rrethanat dhe procedurat aktuale. Për çdo rast, u takonte kërkuarve që të paraqisnin një kërkesë të re pranë Gjykatës për këtë aspekt, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë dhe rregullën 47 të Rregullores së Gjykatës.

7. Gjykata ka juridiksion të shqyrtojë vetëm pranueshmërinë dhe meritat e ankesave fillestare (shih paragrafin 4 më sipër).

B. Pranueshmëria (në lidhje me moszbatimin e vendimit të datës 21 shtator 2011)

1. Pajtureshmëria *ratione personae* dhe *materiae*

8. Qeveria argumenton se kërkuarja e tretë (Flora Kalemí) nuk kishte qenë palë në procedurat gjyqësore dhe në këtë mënyrë nuk ishte në pozitën që të ankohej për moszbatimin e vendimit të formës së prerë të dhënë në ato procedura. Kërkuarja e tretë argumentoi se sipas nenit 200 (d) të Kodit Civil bashkëpronarët mund të kërkonin rikthimin e pjesës së tyre, si edhe të gjësë së zotëruar bashkërisht, që duhej t'i rikthehej të gjithë bashkëpronarëve.

9. Kërkuarit e parë dhe të dytë i ndoqën procedurat gjyqësore nën emrin e tyre, me qëllimin për të mbrojtur të drejtat e tyre të pronësisë. Nuk rezulton se ata vepruan në emër të kërkuarës së tretë. Nuk është e qartë nëse ata bënë ndonjë parashtrim



specifik, në lidhje me nenin 200 të Kodit Civil. Kërkuesja e tretë nuk u përfshi as në procedurat si palë e interesuar dhe as si ndërhyrëse (krahaso me *Mullai dhe të Tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 9074/07, §§ 65, 100, 102 dhe 109, 23 mars 2010). Teksa të tre kërkuesit zotëronin një truall prej 1,031 metra katrorësh, gjetjet e gjykatave vendëse kishin të bënin vetëm për një parcelë me një sipërfaqe prej 622 metra katrorësh, që duhej t'i kthehej paditësve (kërkuesi i parë dhe i dytë). Nuk është provuar në mënyrë bindëse se interesat pronësorë të kërkueses së tretë ndikoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga moszbatimi i vendimit të datës 21 shtator 2011, në lidhje me atë parcelë. Në vijim, ankesat e kërkueses së tretë nuk janë të pajtueshme *ratione personae* dhe *materiae* dhe duhet të rrëzohen në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

2. Shterimi i mjeteve vendëse

10. Në parashtrimet e tyre të vitit 2024, Qeveria argumentoi se në procedurat fillestare, me kërkesë të kërkuesve, gjykatat kishin ndërprerë shqyrtimin e kërkesës pasurore. Sipas gjetjeve në paragrafët 4-7 më sipër, Gjykata konstaton se ky argument nuk lidhet me ankesat që janë nën fushën e veprimit të çështjes konkrete (për moszbatimin e vendimit përfundimtar të datës 21 shtator 2011).

3. Përfundim

11. Gjykata vëren se ankesat e kërkuesve të parë dhe të dytë nuk janë të pambështetura në fakte ose të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

C. Meritat

12. Në lidhje me gjetjet në paragrafin 5 më sipër, parimet e zbatueshme dhe të praktikës gjyqësore përkatëse (shih midis të tjerash, *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, §§ 43-47, 29 shtator 2009, dhe *Gerasimov dhe të Tjerë kundër Rusisë*, nr. 29920/05, dhe 10 të tjerë, §§ 167-74, dhe 182-83, 1 korrik 2014), Gjykata gjykon se Shteti i paditur nuk bëri të gjitha përpjekjet për të zbatuar plotësisht dhe brenda afatit vendimin e datës 21 shtator 2011 të lëna në fuqi në apel më 30 qershor 2014, si në tetor 2014 dhe në nëntor 2015 dhe në vijim. Qeveria nuk ka argumentuar ndryshe.

13. Për këtë arsye, është shkelur neni 6 § 1 i Konventës dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me kërkuesit e parë dhe të dytë për moszbatimin e vendimit.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS

14. Duke pasur në konsideratë faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe gjetjet e saj përmendur më sipër, Gjykata ka shqyrtuar çështjet kryesore ligjore të paraqitura në çështjen konkrete dhe konstaton se nuk është e nevojshme që të jepet një vendim i veçantë për këtë ankesë për sa u përket kërkuesve të parë dhe të dytë (shih *Qendra për Burimet Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM] nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

15. Për sa i përket konstatimit në paragrafin 9 më sipër, ankesa e kërkueses së tretë duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

16. Kërkuesit kërkuan bashkërisht 50,000 euro për dëmin jopasuror dhe në mbështetje të një raporti vlerësimi mbi vlerën e tregut të tokës së tyre, 567,400 euro për shpronësimin e paligjshëm.

17. Qeveria argumentoi se përpara gjykatës vendëse, kërkuesit kishin tërhequr pretendimin e tyre pasuror dhe në këtë mënyrë, nuk kishin shfrytëzuar mjetet vendëse.

18. Gjykata i akordon kërkuesve të parë dhe të dytë së bashku 4,700 euro për dëmin jopasuror. për shkak të mosekzekutimit të vendimit.

19. Gjykata vlerëson se padia për dëmin pasuror me ndikim në vlerën e tregut të tokës nuk ka lidhje rastësore me fushën e veprimit të çështjes (shih paragrafin 5 më sipër) dhe natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljeve të konstatuara, në lidhje me moszbatimin e vendimit. Kërkuesit nuk kërkuan shpërblim të drejtë për dëmin pasuror ose humbjen (të tillë si fitimi nga humbja), në lidhje me pamundësinë për të rifituar zotërimin dhe përdorimin efikas në lidhje me token që ata zotëronin dhe vijnë të zotërojnë (shih *Orlović dhe të Tjerë kundër Bosnjë-Hercegovinës*, nr. 16332/18, § 75, 1 tetor 2019).

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *I deklaron* ankesat në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës të pranueshme për sa i përket kërkuesit të parë dhe të dytë;

2. *I deklaron* ankesat e kërkueses së tretë të papranueshme;

3. *Gjykon* se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës dhe protokollit nr. 1 të Konventës për kërkuesit e



parë dhe të dytë, për moszbatimin e vendimit të datës 21 shtator 2011, të lënë në fuqi më 30 qershor 2014;

4. *Gjykon*, se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pjesa e mbetur e ankesave;

5. *Gjykon*:

a) se shteti përgjegjës duhet t'u paguajë kërkuessve të parë dhe të dytë së bashku, brenda tre muajve, 4,700 euro (katër mijë e shtatëqind euro) plus çdo taksë të tarifueshme për dëmin jopasuror, shumë që duhet të konvertohet në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se që prej përfundimit të periudhës tremujore të përmendur më sipër deri në shlyerje, për shumën

e mësipërme duhet të paguhet interes i thjeshtë, në normën e barabartë me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes së pagesës plus tre pikë përqindje.

6. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuessve për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 11 qershor 2024, sipas rregullës 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Ioannis Ktistakis
KRYETAR

SHTOJCË

Lista e kërkuessve

Nr.	Emri i kërkuessit	Viti i lindjes	Kombësia	Vendbanimi
1	Spiro Kalemi	1937	Shqiptar	Romë
2	Dorina Kalemi	1957	Shqiptare	Tiranë
3	Flora Kalemi	1923	Shqiptare	Tiranë

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA ZELA KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 33164/11)

VENDIM

Neni 6 § 1 (civil) • Koha e arsyeshme • Kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave të kompensimit, që zgjat më shumë se tetë vjet në katër shkallë të juridiksionit, pa tejkaluar atë që mund të konsiderohet e arsyeshme në rrethanat e çështjes

Neni 1 P1 • Privimi i pronës • Shembja e objektit të kërkuessit me arsyetimin që ndërtimi i tij ka qenë i paligjshëm dhe shfuqizimi i titullit të tij të pronësisë pa kompensim • Barra disproporcionale mbi kërkuessin që u detyrua të mbartë të gjitha pasojat për krijimin e situatës e cila çoi në shembjen e objektit pavarësisht përgjegjësisë së përbashkët për të • Rëndësia e veçantë e parimit të qeverisjes së mirë në këtë kontekst • Nuk ka tregues të keqbesimit nga ana e kërkuessit • Mosvendosja e ekuilibrit të drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave të pronësisë së kërkuessit

Përgatitur nga Zyra e Kancelarit. Nuk është i detyrueshëm për Gjykatën.

STRASBURG
11 qershor 2024

Ky vendim do të bëhet përfundimtar në rrethanat e përvaktuara në paragrafin 2 të nenit të Konventës. Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Zela kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet, i përbërë nga:

Jolien Schukking, *President*,
Darian Pavli,
Peeter Roosma,
Ioannis Ktistakis,
Andreas Zünd,
Oddný Mjöll Arnardóttir,
Diana Kovatcheva, *gjyqtarë*,
dhe Milan Blaško, *kancelar Seksioni*,
Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 33164/11) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") nga një shtetas



shqiptar, z. Skënder Zela (“kërkuesi”), më 5 maj 2011;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”), për ankimin në lidhje me padrejtësinë dhe kohëzgjatjen e proceseve sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës, të drejtën e kërkuesit për respektimin e banesës së tij sipas nenit 8 të Konventës, të drejtën e tij për gëzimin e qetë të pasurisë së tij sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës dhe të drejtën e tij për zgjidhjen efektive sipas nenit 13 të Konventës dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura, më 21 maj 2024,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili miratohet po në atë datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me shembjen e objektit të kërkuesit dhe kohëzgjatjen e proceseve në lidhje me pretendimin e tij për kompensim.

FAKTET

2. Kërkuesi ka lindur në vitin 1953 dhe jeton në Tiranë. Ai u përfaqësua nga zyra e avokatisë Haxhia dhe Hajdari, nga Tirana.

3. Fillimisht qeveria përfaqësohej nga Agjencia e saj e asaj kohe znj. A. Hicka dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen si më poshtë.

5. Më 10 dhjetor 1991, Komiteti Ekzekutiv i Qarkut nr. 2 Tiranë (“Komiteti Ekzekutiv”) nxori një autorizim kolektiv që caktonte parcela toke në bregun e lumit Lana për ndërtimin e objekteve të ndryshme, kryesisht kioska si tezga mishi dhe perimesh dhe garazhe. Emri i kërkuesit nuk ishte i përfshirë në atë autorizim.

6. Më 19 maj 1992, Seksioni i Urbanistikës i Komitetit Ekzekutiv, duke iu referuar autorizimit të datës 10 dhjetor 1991, nxori një leje ndërtimi për kërkuesin për një objekt banimi me sipërfaqe 115.5 metër katrorë për kat (462 metër katrorë gjithsej).

Leja u dha për një periudhë gjashtëmujore duke filluar më 1 qershor 1992, që do të thotë se ndërtimi duhej të fillonte më 1 qershor 1992 dhe të përfundonte deri më 1 dhjetor 1992. Sipas lejes objekti do të mbahej për një vit pas përfundimit të ndërtimit. Vetë leja tregonte se ishte dhënë në bazë të dekretit nr. 5747 të Presidiumit të Kuvendit Popullor të datës 29 qershor 1978, të ndryshuar, si

edhe në bazë të vendimit nr. 255 të Presidiumit të Kuvendit Popullor të 30 qershorit 1980, të ndryshuar.

7. Kërkuesi pretendoi se më 19 maj 1992 ai kishte blerë një ngastër toke prej 218 metër katrorë nga Shteti me çmimin prej 18,000 lekësh (LEK).

8. Më 28 mars 1993, kërkuesi përfundoi ndërtimin e një objekti me tre kate dhe një bodrumi. Ajo përfshinte banesën e kërkuesit, si dhe një furrë buke, një magazinë, një dyqan gomash dhe zyra për biznesin e tij. Kati i dytë me sipërfaqe 118.72 metër katrorë dhe papafingo me sipërfaqe 93.75 metër katrorë u shfrytëzuan si zona banimi, ndërsa pjesët e tjera të objektit u përdorën për qëllime biznesi. Sipas një raporti teknik rilevimi të datës 28 mars 1993 ishte kryer një vlerësim përputhshmërie për objektin dhe objekti ishte ndërtuar në truallin në posedim të kërkuesit në përputhje me lejet e lëshuara nga autoritetet përkatëse. Objekti në fjalë ishte për qëllime banimi, kishte një sipërfaqe prej 115.5 metër katrorë dhe ishte ndërtuar në 218.7 metër katrorë truall.

9. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesi i kërkoi Gjykatës së Rrethit Tiranë të njohë si fakt ligjor ekzistencën e një ndërtese banimi trekatëshe me sipërfaqe 115.5 metër katrorë dhe një truall me sipërfaqe 218.7 metër katrorë. Më 30 korrik 1997, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi kërkesën e kërkuesit.

10. Më 16 gusht 1997, kërkuesi e regjistroi objektin si pronën e tij në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe u pajis me një certifikatë pronësie.

11. Më 24 maj 2002, Këshilli i Rregullimit të Territorit Tiranë (“KRIT”), mbështetur në ligjin nr. 8405, datë 17 shtator 1998, për urbanistikën, urdhëroi shembjen e të gjitha objekteve pa leje (të paautorizuara) në segmentin nga ura pranë shkollës “Vasil Shanto” deri tek ura pranë Shkollës Teknologjike në të dyja anët e lumit Lana, pavarësisht vitit të ndërtimit.

12. Më 16 shtator 2002, dy inspektorë të Policisë së Ndërtimit mbajtën një procesverbal sipas të cilit kërkuesi kishte kryer shkelje administrative sipas neneve 45, 66, 75 dhe 77(2) të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, për urbanistikën.

13. Më 17 shtator 2002, Policia e Ndërtimit Tiranë urdhëroi shembjen e objektit të kërkuesit bazuar në vendimin e KRIT-së, të datës 24 maj 2002, dhe procesverbalin e policisë së datës 16 shtator 2002. Kërkuesi u njoftua për atë vendim në



të njëjtën ditë dhe iu dha pesë ditë kohë për të shembur objektin e tij. Kërkuesi depozitoi një ankesë pranë drejtuesit të Policisë së Ndërtimit dhe kërkoi revokimin e urdhrit të shembjes.

14. Më 19 shtator 2002, kërkuesi ngriti një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë kundër Policisë së Ndërtimit Tiranë dhe Bashkisë së Tiranës, ku kërkoi shfuqizimin e urdhrit të shembjes të datës 17 shtator 2002 dhe njohjen si pronar i objektit të banimit me tre kate për të cilin zbatohet urdhri. Ai kërkoi gjithashtu një masë sigurimi në formën e pezullimit të vendimit për shembjen e objektit të tij. Në të njëjtën datë, në një kohë të papërcaktuar, Gjykata e Rrethit Tiranë dha masën e sigurimit të kërkuar deri në përfundimin e procesit, për të shmangur pasoja të pariparueshme për kërkuesin.

15. Objekti i kërkuesit u shemb më 19 shtator 2002.

16. Pas shembjes, kërkuesi ndryshoi pretendimin e tij, duke kërkuar kompensim për prishjen e pronës së tij, përkatësisht një godinë banimi dhe njësi tregtare, dhe për humbjen e truallit, në vlerën 52,850,000 lekë. Ai u bazua në nenet 608 dhe 609 të Kodit Civil (shihni paragrafin 29 më poshtë).

17. Më 16 tetor 2002, drejtuesi i Policisë së Ndërtimit rrëzoi pretendimin e kërkuesit me arsyetimin se vendimi për dhënien e lejes kishte qenë i paligjshëm sipas nenit 1 të dekretit të Presidentit nr. 772 të 14 shkurtit 1994 (shihni paragrafin 31 më poshtë).

18. Në të njëjtin vendim, drejtuesi i Policisë së Ndërtimit ndryshoi vendimin e datës 17 shtator 2002 dhe urdhëroi prishjen e objektit të kërkuesit bazuar në shkeljet e neneve 45 dhe 77(2) të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 për urbanistikën.

19. Në një seancë të mbajtur më 18 tetor 2002 në Gjykatën e Rrethit Tiranë, kërkuesi kërkoi shfuqizimin e vendimit të datës 16 tetor 2002.

20. Në një vendim të datës 15 prill 2003, Gjykata e Rrethit Tiranë rrëzoi kërkesën e ankuesit për kompensim dhe revokoi masën e saj të sigurimit të datës 19 shtator 2002.

Gjykata e Rrethit vendosi që dëmshpërblimi jokontraktor sipas neneve 608 dhe 609 të Kodit Civil të mund të jepej kur të ishin plotësuar katër kushtet e mëposhtme akumuluese: një veprim ose mosveprim i paligjshëm; ekzistenca e dëmit; fajit; dhe një lidhjeje shkakësore ndërmjet veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të shkaktuar. Gjykata e Rrethit konstatoi se mungonte të paktën një nga

këto elemente, përkatësisht një veprim ose mosveprim i kundërligjshëm nga ana e të paditurve.

Për sa i përket kërkesës së ankuesit për dëmshpërblim në lidhje me prishjen e objektit të tij, Gjykata e Rrethit gjeti se ndërtimi i objektit kishte qenë i paligjshëm për shkak se kërkuesi nuk kishte provuar se ai e kishte blerë truallin ku ishte ndërtuar objekti. Ai kishte paraqitur vetëm një faturë sipas të cilës ai i kishte paguar Shtetit 18,000 lekë. Megjithatë, qëllimi i asaj pagese nuk ishte i qartë sepse nuk ishte specifikuar në faturë. Për më tepër, kjo faturë nuk mund të shërbente në vetvete si provë për blerjen e truallit nga shteti. Që kjo blerje të ishte e vlefshme, duhej të lidhej një kontratë e shkruar në formën e një akti noterial dhe kjo kontratë duhej të regjistrohej, siç e kërkonte paragrafi 2 i nenit 89 të Kodit Civil të vitit 1981. Meqenëse kërkuesi nuk i kishte përmbushur këto kërkesa, ai nuk provoi se ishte bërë pronar i truallit në fjalë, duke e bërë të paligjshëm çdo objekt të ndërtuar në të.

Leja e ndërtimit, e datës 19 maj 1992, i ishte dhënë kërkuesit vetëm për gjashtë muaj, që do të thotë se ndërtimi duhej të fillonte më 1 qershor 1992 dhe të përfundonte deri më 1 dhjetor 1992. Objekti i ndërtuar sipas lejes lejohej të mbahej për një vit pas përfundimit të ndërtimit. Pas mbarimit të kësaj periudhe, kërkuesi duhej të kërkonte një leje të re. Megjithatë, kërkuesi nuk kishte provuar përfundimin e ndërtimit deri më 1 dhjetor 1992. Ai e kishte regjistruar objektin e ndërtuar vetëm më 16 gusht 1997, pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë të datës 30 korrik 1997.

Megjithatë, sipas nenit 193 të Kodit Civil, një vendim gjyqësor që vërteton thjesht një fakt juridik (të posedimit) nuk mund të shërbejë si provë e titullit të pronësisë. Për më tepër, kërkuesi kishte ndryshuar qëllimin e objektit duke e përdorur atë si pronë tregtare, duke shkelur në këtë mënyrë dekretin nr. 5747, datë 29.6.1978, për urbanistikën, i cili lejonte vetëm ndërtimin e banesave për përdorim personal nga individë në zonat urbane.

Policia e Ndërtimit kishte të drejtë të urdhëronte që të prisheshin objektet e paligjshme. Për më tepër, neni 77 i ligjit nr. 8405 (1998), për urbanistikën, parashikonte prishjen e çdo objekti të paligjshëm që pengonte ecurinë e projekteve sipas studimeve të miratuara.

Vendimi i KRTT-së, i datës 24 maj 2002, kishte përcaktuar se ndërtimet e paligjshme në segmentin e caktuar të brigjeve të lumit Lana kishin qenë pengesë



për zbatimin e planeve të Bashkisë së Tiranës për punimet në shtratin e lumit Lana dhe të një pjese të kolektorit kryesor të ujërave të zeza në atë segment të lumit.

Të gjitha konsideratat e mësipërme e çuan Gjykatën e Rrethit në përfundimin se vendimet që urdhëronin prishjen dhe shembjen aktuale të objektit të paligjshëm të kërkuarit nuk kishin qenë të paligjshme. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit për dëmshpërblim në lidhje me humbjen e truallit, Gjykata e Rrethit u shpreh se kërkuari nuk kishte provuar se ai kishte qenë pronar i atij trualli.

21. Pas ankimit nga kërkuari, Gjykata e Apelit Tiranë, më 24 dhjetor 2003, la në fuqi pjesërisht vendimin e shkallës së parë për sa i përket pretendimit kundër Bashkisë së Tiranës dhe e rrëzoi atë për sa i përket pretendimit kundër drejtuesit të Policisë së Ndërtimit, duke urdhëruar këtë institucion t'i paguajë kërkuarit 52 850 000 lekë për dëmin e shkaktuar nga prishja e objektit të banimit dhe njërive tregtare në pronësi të kërkuarit.

22. Më 6 tetor 2005, Gjykata e Lartë prishi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe e ktheu çështjen në apel.

23. Më 8 maj 2007, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë të datës 15 prill 2003, duke miratuar arsyetimin e saj.

24. Më 6 qershor 2007, kërkuari paraqiti një ankim në Gjykatën e Lartë, e cila e rrëzoi atë përfundimisht më 12 qershor 2009.

25. Më 12 prill 2010, kërkuari bëri një ankim kushtetues, duke dhënë adresën e avokatit të tij: rruga “Komuna e Parisit”, pall. 2/2.

26. Më 22 korrik 2010, një trup gjykues prej tre gjyqtarësh i Gjykatës Kushtetuese e rrëzoi ankimin kushtetues të kërkuarit si haptazi të pabazuar. Sipas Qeverisë, ai vendim iu dërgua avokatit të kërkuarit me postë më 20 shtator 2010 në adresën që ai kishte dhënë në ankimin kushtetues.

27. Më 2 prill 2011, avokati i kërkuarit i dërgoi një shkresë Gjykatës Kushtetuese për të pyetur për çështjen e kërkuarit. Në atë shkresë ai jep të njëjtën adresë. Gjykata Kushtetuese i është përgjigjur me një shkresë të datës 4 prill 2011 dërguar avokatit të kërkuarit në adresën: rruga “Komuna e Parisit”, pall. 2/2, duke u shprehur se kishte nxjerrë vendimin për çështjen e kërkuarit më 22 korrik 2010 dhe ia kishte dërguar tashmë avokatit të kërkuarit më 20 shtator 2010. Gjykata Kushtetuese bashkëngjiti shkresën e datës 20 shtator 2010.

KUADRI LEGAL PËRKATËS DHE PRAKTIKA

I. KODI CIVIL 1981

28. Pjesa përkatëse e nenit 89 të Kodit Civil 1981 parashikon që kontrata për transferimin e pronës është e vlefshme vetëm nëse është lidhur në formën e një akti noterial dhe më pas është regjistruar.

II. KODI CIVIL 1994

29. Neni 193, paragrafi 1 shkronja dh i Kodit Civil 1994 lexon *inter alia* që vendimet e gjykatës për njohjen e pronësisë së pronës regjistrohen në Regjistrin e Tokave si dëshmi e titullit. Paragrafi 2 i atij neni parashikon që vendimet e gjykatës të cilat njohin faktin juridik të pronësisë nuk regjistrohen në Regjistrin e Tokave, që do të thotë se nuk mund të shërbejnë si dëshmi e titullit. Neni 608 i Kodit Civil lexon që kushdo i cili në mënyrë të paligjshme i ka shkaktuar dëm një personi tjetër ose pronës së atij personi ka detyrimin të paguajë kompensim për atë dëm, përveçse nëse ai ose ajo provon se nuk ka qenë në faj. Neni 609 lexon që dëmi mund të jetë rezultat i veprimit ose mosveprimit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të personit.

III. LIGJI NR. 7693 I 6 PRILLIT 1993 PËR URBANISTIKËN

30. Sipas nenit 29 të ligjit nr. 7693, afati kohor për të kërkuar leje ndërtimi pas miratimit të truallit të ndërtimit ishte ndërmjet tre dhe gjashtë muajve, në varësi të sipërfaqes së truallit të ndërtimit. Këshillat përkatës kishin kompetencë të zgjasnin ato afate kohore; megjithatë mosrespektimi i afateve kohore e bëri të pavlefshëm miratimin fillestar të truallit të ndërtimit.

IV. DEKRETI Nr. 772 I 14 SHKURTIT 1994

31. Neni 1 i dekretit nr. 772 të 14 shkurtit 1994 (shihni paragrafin 17 më sipër), i ndryshuar me ligjin nr. 7693, të 6 prillit 1993, për urbanistikën, duke shtuar nenin 29 (a) i cili parashikon që pjesa tjetër e atij neni zbatohet edhe për çdo truall ndërtimi të miratuar nga organet e qeverisjes vendore pas 1 janarit 1990. Më tej, lexon që personat juridikë ose fizikë do të rimbursohen për çmimin që kanë paguar për një truall ndërtimi nëse revokohet vendimi që miraton blerjen e tij.

V. LIGJI NR. 8405, I 17 SHKURTIT 1998, “PËR URBANISTIKËN”

32. Pjesët përkatëse të ligjit nr. 8405 lexojnë si më poshtë. Sipas nenit 4 të gjitha ndërtimet në Shqipëri duhet të jenë në përputhje me studimet e planifikimit urban dhe mjedisor, normat dhe kushtet



teknike dhe të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Neni 44 kërkon që sheshet e mundshme të ndërtimit të miratohen ose të refuzohen brenda dy muajve. Neni 45 kërkon që të merret leje ndërtimi për të gjitha ndërtimet. Neni 66 parashikon që ndërtimi në zonat turistike të mbrojtë mjedisin dhe të ndalohet nëse nuk ka infrastrukturë inxhinerike të miratuar. Neni 75 parashikon që ndërtimet e paligjshme të gjobiten dhe mund të përfundojnë me shembjen e tyre. Drejtuesi i Policisë së Ndërtimit është kompetent për vënien e gjobave dhe nxjerrjen e urdhrave të shembjes, ndërsa Policia e Ndërtimit ekzekuton urdhrat e shembjes. Neni 77 përcakton kompetencat e Këshillit të Rregullimit të Territorit në varësi të Bashkisë së Tiranës dhe qyteteve të tjera të kategorisë së parë (KAT) në lidhje me objektet e paligjshme të ndërtuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit në fjalë. Në veçanti, paragrafi 2 parashikon se kur këto objekte përbëjnë rrezik për mjedisin ose zënë hapësirë publike, urdhërohet dhe kryhet menjëherë shembja e tyre.

VI. PRAKTIKA E GJYKATËS KUSHTETUESE PËR DHËNIEN E VENDIMEVE

33. Sipas rregullores së brendshme (2009) dhe praktikës përkatëse të Gjykatës Kushtetuese, në fuqi në atë kohë, vendimet e gjykatës plenare shpallehin ose në seancë publike, ku ishin ftuar palët, ose me dorëzimin e vendimit të shkruar te palët. Vendimet e trupave me tre gjyqtarë (*kolegj*) të gjykatës për papranueshmërinë e ankimeve individuale, si rregull, u dërgoheshin palëve me postë.

LEGJISLACIONI

I. KOMENTE PARAPRAKE

Respektimi i afatit gjashtë mujor

1. Parashtrimet e palëve

34. Qeveria parashtroi se kërkesa ishte depozituar jashtë afatit gjashtëmujor, sepse Gjykata Kushtetuese i kishte dërguar vendimin e saj të datës 22 korrik 2010 avokatit të kërkesit më 20 shtator 2010 në adresën e dhënë në ankimin kushtetues. Mirëpo, duke qenë se avokati nuk e kishte njoftuar Gjykatën Kushtetuese për ndryshimin e emrit të rrugës, ai nuk mund të ankohej që vendimi nuk i ishte dorëzuar si duhej. Madje, edhe në shkresën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese të datës 2 prill 2011, ai kishte dhënë të njëjtën adresë.

35. Kërkesi parashtroi se vendimi i datës 22 korrik 2010 i ishte njoftuar avokatit të tij vetëm pasi ai i kishte dërguar një shkresë Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet avokatit të tij më 2 prill 2011 ku pyeste

për çështjen. Ai gjithashtu theksoi se Qeveria nuk kishte paraqitur asnjë provë që vendimi i ishte njoftuar avokatit të tij më herët. Ai më tej parashtroi se emri i rrugës së avokatit të tij kishte ndryshuar dhe se vendimi nuk ishte dërguar në adresën e saktë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

36. Gjykata thekson praktikën e përgjithshme të Gjykatës Kushtetuese që vendimet e trupave të gjykimit me tre gjyqtarë (*kolegj*) për papranueshmërinë e kërkesave individuale u dërgohen palëve me postë (shihni paragrafin 33 më lart). Gjykata nuk ka asnjë arsye të vërë në dyshim pohimin e Qeverisë se më 20 shtator 2010, Gjykata Kushtetuese i kishte dërguar avokatit të kërkesit vendimin e saj të datës 22 korrik 2010. Gjykata thekson gjithashtu se Gjykata Kushtetuese, pas shkresës së datës 2 prill 2011 nga avokati i kërkesit, i dërgoi avokatit të njëjtën vendim më 4 prill 2011, duke vënë në dukje në shkresën përcjellëse se ai vendim i ishte dërguar tashmë më 20 shtator 2010.

37. Gjykata pajtohet me Qeverinë që avokati i kërkesit kishte për detyrë të informonte Gjykatën Kushtetuese për ndryshimin e adresës. Megjithatë, duket se ndryshimi i emrit të rrugës nuk ka ndikuar në dorëzimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese tek avokati i kërkesit, pasi Gjykata Kushtetuese i kishte dërguar shkresat e datës 20 shtator 2010 dhe 4 prill 2011, me vendimin e bashkëngjitur, në të njëjtën adresë dhe shkresa e datës 4 prill 2011 iu dorëzua siç duhet avokatit të kërkesit në të njëjtën adresë.

38. Fakti që më 20 shtator 2010, Gjykata Kushtetuese i dërgoi kërkesit një shkresë të cilës i kishte bashkëngjitur vendimin e saj të datës 22 korrik 2010, nuk do të thotë se kërkesi në fakt e ka marrë atë. I takon Qeverisë së paditur, e cila mbështetet në mospërmbyshjen e afatit 6-mujor, që të caktojë datën kur kërkesi ka marrë dijeni për vendimin e brendshëm përfundimtar (shihni *Şahmo kundër Turqisë* (vendim), nr. 37415/ 97, 1 prill 2003, dhe *Belozorov kundër Rusisë dhe Ukrainës*, nr. 43611/02, §§ 93-97, 15 tetor 2015). Qeveria nuk ka paraqitur asnjë provë, si p.sh. fletë-dorëzimi, që tregon se vendimi i ishte dorëzuar avokatit të kërkesit, ose që dorëzimi është tentuar të paktën, por nuk ka qenë i mundur për shkak të adresës së gabuar (krahasoni *Mumladze kundër Gjeorgjisë*, nr. 30097/03, § 47, 8 janar 2008; *Rassobin kundër Moldavisë* nr. 11373/05, § 34, 18 tetor 2011;



Lazarenko dhe të tjerë kundër Ukrainës nr. 70329/12 dhe 5 të tjerë § 38, 27 qershor 2017; dhe *Belova kundër Rusisë*, nr. 33955/08, § 51, 15 shtator 2020).

39. Në këto rrethana, Gjykata nuk mund të supozojë se avokati i kërkuarit ka marrë vendimin e Gjykatës Kushtetuese përpara datës 4 prill 2011. Meqenëse kërkesa në fjalë është depozituar në Gjykatë më 5 maj 2011, rrjedh se afati gjashtëmuajor i përcaktuar në nenin 35 § 1 të Konventës, në fuqi në kohën në fjalë, është respektuar dhe që kundërshtimi i Qeverisë duhet të rrëzohet.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

40. Kërkuarisi u ankua për kohëzgjatjen e procedurave për kompensim. Ai u mbështet në paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës, i cili lexon:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile... çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet... brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë...”.

A. Pranueshmëria

41. Gjykata vëren se ky ankim nuk është as haptazi i pabazuar dhe as i papranueshëm për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

42. Kërkuarisi u ankua se kohëzgjatja e procesit civil që kishte nisur më 19 shtator 2002 dhe që kishte përfunduar më 22 korrik 2010, kishte qenë e tepruar.

43. Qeveria parashtrroi se kohëzgjatja e procesit në fjalë kishte qenë e arsyeshme.

2. Vlerësimi i Gjykatës

44. Parimet e përgjithshme në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përmbledhen në çështjen *Frydlander kundër Francës* ([DHM], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII).

45. Procesi i ankimuar filloi më 19 shtator 2002 dhe përfundoi me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 22 korrik 2010. Megjithatë, vendimi iu dorëzua avokatit të kërkuarëve më 4 prill 2011. Kështu, procesi zgjati tetë vjet, gjashtë muaj dhe pesëmbëdhjetë ditë në katër shkallë juridiksioni (krahasoni, për sa i përket kohës që do të shqyrtohet *Kirsten kundër Gjermanisë*, nr. 19124/02, § 37, 15 shkurt 2007; *Zorc kundër Sllovenisë*, nr. 2792/02, § 28, 2 nëntor 2006 dhe *Sylvester kundër Austrisë* (nr. 2), § 29, 3 shkurt 2005). Për shkak të një kthimi çështjeje, vendimet u dhanë në gjashtë raste (krahasoni *Seliga*

kundër Sllovenisë (vendim), nr. 33578/02, 30 nëntor 2006).

46. Gjykata vlerëson se çështja ishte mjaft komplekse pasi përfshinte çështje të vështira në lidhje me vlefshmërinë e titullit të pronësisë së kërkuarëve dhe planifikimin urban.

47. Për sa i përket sjelljes së kërkuarëve, Gjykata konstaton se ai kontribuoi në zgjatjen e proceseve duke paraqitur një ankim kushtetues rreth dhjetë muaj pas dhënies së vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë (shihni paragrafët 24 dhe 25 më sipër).

48. Lidhur me sjelljen e gjykatave të brendshme, Gjykata vëren se asnjë prej gjykatave që trajtojnë çështjen nuk mori më shumë se tre vjet kohë për të dhënë vendimin e saj. Duke pasur parasysh këtë vëzhgim dhe praktikën gjyqësore të saj (shihni, për shembull, *L.Z. kundër Sllovakisë* (vendim), nr. 27753/06, 27 shtator 2011, dhe *Lyszczyzna kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 34863/04, 4 janar 2008), Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e përgjithshme prej tetë vjetësh në katër shkallë juridiksioni, me vendime të dhëna në gjashtë raste të veçanta, nuk e ka kaluar atë që mund të konsiderohej kohë e arsyeshme në këto rrethana (krahasoni *Eckholm kundër Finlandës* (vendim), nr. 5952/03, 10 korrik 2007, dhe *Steiner kundër Austrisë* (vendim), nr. 32637/96, 22 nëntor 2001).

49. Në këto rrethana konstatohet shkelje e paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

50. Kërkuarisi u ankua për shembjen e objektit të tij dhe për faktin se nuk kishte marrë asnjë kompensim për këtë qëllim. Ai u mbështet në paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës dhe nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës. Gjykata, duke qenë kompetente për cilësimin që duhet t'i jepet në ligj fakteve të çështjes, do të shqyrtojë ankimin vetëm sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës (krahasoni *Ibrahimbeyov dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit*, nr. 32380/13, § 39, 16 shkurt 2023), i cili lexon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të qetë të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.



Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

A. Pranueshmëria

1. Zbatueshmëria e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës

a) Parashtrimet e palëve

51. Qeveria parashtroi se kërkuksi nuk mund të shihej si viktimë e shkeljes së nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, sepse ai nuk kishte qenë pronar i objektit në fjalë dhe sepse ajo ndërtesë nuk mund të përbënte pasuri.

52. Kërkuksi parashtroi se ai kishte qenë pronar i objektit në fjalë dhe i truallit mbi të cilin ajo ishte ndërtuar.

b) Vlerësimi i Gjykatës

53. Gjykata vlerëson se këto argumente kanë të bëjnë me pyetjen nëse kërkuksi kishte një “pasuri” dhe për rrjedhojë nëse zbatohet neni 1 i protokollit nr. 1. Gjykata ka vërtetuar se çështja e zbatueshmërisë së një dispozite të veçantë të Konventës ose protokolleve të saj është çështje e juridiksionit *ratione materiae* të Gjykatës dhe që analiza përkatëse duhet të kryhet në fazën e pranueshmërisë, përveçse nëse ka një arsye të veçantë për ta bashkuar këtë çështje me themelin (shihni *Savickis dhe të tjerë kundër Letonisë* [DHM], nr. 49270/11, § 119, 9 qershor 2022). Në këtë çështje nuk ekziston kjo arsye e veçantë.

54. Gjykata thekson se një kërkuks mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 vetëm në masën që vendimet e kundërshtuara kanë të bëjnë me “pasurinë” e tij/saj sipas kuptimit të kësaj dispozite. “Pasuria” mund të jetë “pasuri ekzistuese” ose pretendime që janë vërtetuar mjaftueshëm për t’u konsideruar si “asete” (shihni *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], nr. 44912/98, § 35, GJEDNJ 2004-IX, dhe *Radomilja dhe të tjerë kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, § 142, 20 mars 2018).

55. Sipas vendimeve të gjykatave të brendshme, objekti i kërkuksit ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme dhe ai konsiderohej se nuk e kishte pasur kurrë atë në pronësi. Megjithatë, Gjykata vëren se në vitin 1992 kërkuksi mori një leje ndërtimi për objektin në fjalë dhe se pronësia e tij ishte regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

(shihni paragrafin 10 më lart) dhe ai e posedonte objektin për më shumë se nëntë vjet.

56. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuksi kishte një “pasuri” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës edhe nëse mund të pretendohet se titulli i tij ishte i pavlefshëm *ab initio* (krahasoni *Gashi kundër Kroacisë*, nr. 32457/05, § 22, 13 dhjetor 2007).

57. Rrjedhimisht, kundërshtimi i Qeverisë në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës duhet të rrëzohet.

2. Abuzimi me të drejtën për kërkesë

a) Parashtrimet e palëve

58. Qeveria pretendoi më tej se kërkuksi kishte abuzuar me të drejtën e tij për kërkesë për shkak se ai nuk kishte paraqitur lejen origjinale të ndërtimit përpara gjykatave të brendshme dhe Gjykatës.

59. Kërkuksi u shpreh se ai kishte marrë një leje të ligjshme ndërtimi nga një organ kompetent sipas rregullave përkatëse të zbatueshme të asaj kohe.

b) Vlerësimi i Gjykatës

60. Pjesa e rëndësishme e paragrafit 3 të nenit 35 të Konventës lexon:

“Gjykata deklaron çdo kërkesë individuale të bërë në bazë të nenit 34 të papranueshme, kur mendon se:

a) kërkesa është e papajtueshme me dispozitat e Konventës ose protokollet e saj, haptazi e paarsyetuar ose abuzim i së drejtës për kërkesë individuale;

...”

61. Gjykata thekson se sipas kësaj dispozite një kërkesë mund të refuzohet si abuzim i së drejtës për kërkesë individuale, nëse, ndër arsyet e tjera, është bazuar me vetëdije në fakte të pavërteta. Paraqitja e informacionit të paplotë dhe për rrjedhojë ngatërrues mund të përbëjë gjithashtu abuzim të së drejtës për kërkesë, sidomos nëse informacioni ka të bëjë me thelbin e çështjes dhe nuk është dhënë shpjegim i mjaftueshëm për mosdhënien e këtij informacioni. Megjithatë, edhe në këto raste, qëllimi i kërkuksit për të ngatërruar Gjykatën duhet të provohet gjithmonë me siguri të mjaftueshme (shihni *Gross kundër Zvicrës* [DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014, dhe çështjet e cituara aty). Me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, një kërkesë mund të refuzohet si abuzim i së drejtës për kërkesë vetëm nëse është bazuar me vetëdije në fakte të pavërteta (shihni *Varbanov kundër Bullgarisë*,



nr. 31365/96, § 36, GJEDNJ 2000-X, dhe *Zaytsev kundër Rusisë*, nr. 22644/02, § 16, 16 nëntor 2006).

62. Duke iu kthyer rrethanave të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuksi parashtroi se kishte marrë leje ndërtimi në përputhje me të gjitha rregulloret përkatëse të asaj kohe – një argument të cilin ai e kishte paraqitur edhe para gjykatave të brendshme. Nuk ka asgjë që të tregojë se kërkuksi, duke bërë këto parashtrime, kishte për qëllim të ngatërronte Gjykatën ose që ai me vetëdije paraqiti ndonjë fakt të pavërtetë.

63. Duke pasur parasysh deklaratat e bëra nga kërkuksi në çështjen në fjalë, Gjykata nuk vlerëson se ato përbëjnë abuzim të së drejtës për kërkesë. Prandaj, kundërshtimi i Qeverisë rrëzohet.

3. Konkluzione mbi pranueshmërinë

64. Gjykata vëren se ky ankim nuk është as haptazi i pabazuar dhe as i papranueshëm për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

a) Kërkuksi

65. Kërkuksi parashtroi se shembja e ndërtesës së tij ishte kryer në shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës. Ai pretendoi se shembja nuk ishte e bazuar në ligj. Në këtë drejtim, ai parashtroi se, në kundërshtim me parashtrimet e Qeverisë, leja e ndërtimit për objektin në fjalë nuk i ishte dhënë në bazë të vendimit të Komitetit Ekzekutiv të datës 10 dhjetor 1991, por në bazë të dekretit nr. 5747 të Presidiumit të Kuvendit Popullor të datës 29 qershor 1978, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 255 të Presidiumit të Kuvendit Popullor të 30 qershorit 1980, të ndryshuar.

66. Për sa i përket pretendimit të Qeverisë që emri i tij nuk ishte përfshirë në vendimin e Komitetit Ekzekutiv të datës 10 dhjetor 1991, kërkuksi parashtroi që leja e ndërtimit ishte dhënë sipas legjislacionit përkatës të asaj kohe, në bazë të planeve rregulluese, studimeve të pjesshme të planifikimit urban, planimetrisë së sheshit të ndërtimit, planimetrisë së objekteve dhe lejes së ndërtimit. Në lidhje me këtë, kërkuksi u mbështet në nenin 8 të dekretit nr. 5747 të Presidiumit të Kuvendit Popullor të 29 qershorit 1978, i cili parashikonte se hapi i parë në ndërtim në qytete dhe fshatra me zona të banuara ishte marrja e një leje

ndërtimi, e cila jepej pasi ishte përgatitur sheshi i ndërtimit dhe ishte miratuar projekti.

67. Në rastin e kërkuksit, Komiteti Ekzekutiv, si organ kompetent, kishte dhënë lejen e ndërtimit pasi sheshi i ndërtimit ishte miratuar në bazë të planit rregullues. Leja ishte dhënë për një objekt banimi dhe për një periudhë njëvjeçare nga data e lëshimit.

68. Më tej, kërkuksi parashtroi se ai kishte respektuar afatin kohor dhe kushtet e tjera për ndërtimin e ndërtesës së tij, siç përcaktohet nga raporti teknik të rilevimit të 28 marsit 1993. Ai parashtroi gjithashtu se gjykata kishte njohur ligjshmërinë e objektit dhe e kishte regjistruar siç duhet atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku të gjitha këto provonin pronësinë e tij mbi ndërtesën dhe truallin në fjalë.

69. Kërkuksi u shpreh se ndërtesa e tij ishte shembur në bazë të vendimit të KRTT-së të 24 majit 2002, i cili kishte urdhëruar shembjen e të gjitha strukturave të paligjshme përgjatë një segmenti të caktuar të brigjeve të lumit Lana. Shembja kishte ndodhur pavarësisht se objekti i tij nuk ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme. Përkundrazi, ai kishte marrë të gjitha lejet e nevojshme për objektin, e kishte regjistruar siç duhet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kishte marrë një certifikatë pronësie për të.

70. Kërkuksi më tej u shpreh se drejtuesi i Policisë së Ndërtimit, duke refuzuar ankimin e tij kundër vendimit për shembjen e objektit të tij, e kishte gjetur të paligjshme lejen e ndërtimit sipas nenit 1 të dekretit nr. 772, datë 14 shkurt 1994. Kërkuksi u ankua se ai dekret ishte zbatuar në mënyrë retrospektive dhe se drejtuesi i Policisë së Ndërtimit nuk kishte dhënë asnjë arsye për një zbatim të tillë retrospektiv.

71. Për sa i përket qëllimit legjitim, kërkuksi pranoi se interesat e politikës urbanistike mund të justifikonin shembjen e pronës.

72. Lidhur me proporcionalitetin e masës, kërkuksi parashtroi se vendimi i KRTT-së, i cili kishte shërbyer si bazë për shembjen e ndërtesës së tij, ishte nxjerrë më shumë se nëntë vite pasi ai kishte përfunduar ndërtimin dhe ishte njohur si pronar i ligjshëm.

Kështu, atij mund t'i privohej prona e tij vetëm përmes shpronësimit me kompensim e duhur.

73. Kërkuksi u ankua gjithashtu se ndërtesa e tij ishte shembur pavarësisht nga masës së sigurimit të Gjykatës së Rrethit të Tiranës që pezullonte



vendimin e Policisë së Ndërtimit për prishjen e saj, dhe pavarësisht faktit që ankimi i tij kundër këtij vendimi ishte ende në proces pranë drejtuesit të Policisë së Ndërtimit.

b) Qeveria

74. Qeveria u shpreh se leja e ndërtimit e datës 19 maj 1992, mbi bazën e së cilës kërkuesi kishte ndërtuar objektin në fjalë, supozohej se ishte lëshuar në bazë të një autorizimi të mëparshëm për sipërfaqen e truallit të datës 10 dhjetor 1991, i cili megjithatë nuk përmendte emrin e kërkuesit dhe kishte të bënte me ngritjen e kioskave të përkohshme nga palët e treta. Gjithashtu, kërkuesi nuk kishte respektuar kushtet e lejes që rregullonin llojin e ndërtimit dhe afatet kohore. Për sa i përket truallit në të cilin ishte ngritur objekti, Qeveria parashtroi se e vetmja provë që kërkuesi kishte paraqitur për blerjen e asaj toke ishte një faturë që nuk përmendte sipërfaqen ose vendndodhjen e truallit. Për më tepër, një faturë në vetvete nuk mund të shërbente si dëshmi pronësie për truallin i cili kërkonte akt noterial dhe regjistrim. Prandaj, kërkuesi nuk kishte qenë kurrë pronar i objektit apo truallit në fjalë.

75. Qeveria u shpreh se objekti i kërkuesit kishte qenë i paligjshëm, siç edhe kishin vendosur autoritetet e brendshme. Prandaj, prishja e tij kishte një bazë ligjore dhe ishte e nevojshme pasi binte ndesh me planin urbanistik për atë segment të brigjeve të lumit Lana. Në kohën përkatëse kishte pasur një numër të konsiderueshëm ndërtimesh të paligjshme në Shqipëri dhe masat për prishjen e këtyre strukturave kishin qenë në interes të publikut. Kjo kishte qenë veçanërisht e vërtetë për sa u përket ndërtesave në zona që, si në rastin e kërkuesit, ishin menduar si hapësira të gjelbra dhe pa ndërtime.

76. Qeveria gjithashtu pretendoi se kërkuesi nuk kishte të drejtë për kompensim pasi ndërtesa e tij kishte qenë e paligjshme.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Nëse ka pasur ndërhyrje

77. Neni 1 i protokollit nr. 1 përmban tre rregulla të dallueshme: rregulli i parë, i përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është i një natyre të përgjithshme dhe shpall parimin e gëzimit të qetë të pasurisë; rregulli i dytë, i përfshirë në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon privimin nga prona dhe ia nënshtron disa kushteve; rregulli i tretë, i shprehur në paragrafin e dytë, njeh se Shtetet kanë të drejtë, ndër të tjera, të kontrollojnë përdorimin e pronës në

përputhje me interesin e përgjithshëm. Megjithatë, këto rregulla nuk janë të palidhura: rregulli i dytë dhe i tretë ka të bëjë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin e qetë të pasurisë dhe për këtë arsye duhet të interpretohen sipas parimit të përcaktuar në rregullin e parë (shihni, për shembull, *Kozacıoğlu kundër Turqisë* [DHM], nr. 2334/03, § 48, 19 shkurt 2009, dhe *Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* [DHM], 71243/01, § 93, 25 tetor 2012).

78. Në çështjen në fjalë, kërkuesi u privua nga prona e tij si pasojë e shembjes së objektit dhe gjetjeve vijuese të Gjykatës së Rrethit Tiranë në vendimin e saj të datës 15 prill 2003, që u lanë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Në bazë të këtyre vendimeve, titulli i kërkuesit për objektin në fjalë u shfuqizua.

79. Gjykata i referohet më tej jurisprudencës së saj të konsoliduar, sipas së cilës shembja e pronës dhe heqja e titullit të pronësisë përbën privim sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1 (krahasoni *Kolona kundër Qipros*, nr. 28025/03, § 70, 27 shtator 2007; *Akhverdiyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 76254/11, § 80, 29 janar 2015; *Khalikova kundër Azerbajxhanit*, nr. 42883/11, § 135, 22 tetor 2015; dhe *Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 10613/16, § 170, 11 janar 2018). Gjykata duhet të shqyrtojë më tej nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar.

b) Justifikimi për ndërhyrjen në gëzimin e qetë të pasurisë

i) Nëse ndërhyrja ka qenë e ligjshme

80. Për sa i përket faktit nëse ndërhyrja ishte e bazuar në ligj, Gjykata vëren se vendimi i parë i KRIT-së mbështetej në ligjin nr. 8405 (1998), për urbanistikën, dhe se kërkuesi pretendoi që vendimi ishte zbatuar në mënyrë retroaktive sepse ndërtimi i objektit të tij kishte përfunduar në vitin 1993. Megjithatë, Gjykata vëren se vendimi përfundimtar i Policisë së Ndërtimit i referohej dekretit 772/94, i cili e bënte nenin 29 të ligjit nr. 7693 (1993) të zbatueshëm në mënyrë retroaktive për të gjitha lejet e ndërtimit të lëshuara që nga 1 janari 1990 (shihni paragrafin 31 më lart), duke përfshirë këtu edhe lejet e kërkuesit. Prandaj, në kohën përkatëse kishte një bazë ligjore për të përcaktuar se objekti i kërkuesit kishte qenë një ndërtim i paligjshëm dhe, sipas ligjit nr. 8405 (1998), për të urdhëruar shembjen e tij si të tillë. Për më tepër, Gjykata vëren se objekti i kërkuesit u shemb sepse u konsiderua i paligjshëm nga autoritetet administrative. Gjykata pranon se



nuk mund të thuhet që prishja e ndërtimeve pa leje nuk ishte e bazuar në ligj.

ii) Ndërsa ndërhyrja ka ndjekur një qëllim legjitim

81. Gjykata vëren se objekti i kërkesës u prish në bazë të vendimit të KRTT-së të datës 24 maj 2002, me arsyetimin se ndërtimi i tij ishte i paligjshëm dhe në kundërshtim me rregullat urbanistike të zonës. Gjykata pranon se prishja e objekteve të paligjshme që bien ndesh me ligjet dhe rregullat e urbanistikës i shërben një interesi publik legjitim.

iii) Nëse ndërhyrja ka qenë proporcionale me qëllimin legjitim të cilin i ka shërbyer

82. Gjykata shprehur se ekuilibri që duhet mbajtur ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore preket nëse personit në fjalë i është dashur të mbajë një barrë joproporcionale (shihni, mes shumë vendimeve të tjera, *Bélané Nagy kundër Hungarisë* [DHM], nr. 53080/13, § 115, 13 dhjetor 2016, dhe çështjet e cituara aty). Pavarësisht nga kufiri i vlerësimit që i është dhënë Shtetit, Gjykata megjithatë, në ushtrimin e kompetencës së saj të rishikimit, duhet të përcaktojë nëse është ruajtur ekuilibri i nevojshëm në një mënyrë që është në përputhje me të drejtën e pronësisë së kërkesës (shihni *Rosinski kundër Polonisë*, nr. 17373/02, § 78, 17 korrik 2007). Shqetësimi për të arritur këtë ekuilibër reflektohet në strukturën e nenit 1 të protokollit nr. 1 në tërësi, duke përfshirë rrjedhimisht fjalinë e dytë të paragrafit të parë, e cila duhet lexuar sipas parimit të përgjithshëm të shprehur në fjalinë e parë. Në veçanti, duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet me çdo masë që privon një person nga pasuria e tij (shihni *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerë kundër Belgjikës*, 20 nëntor 1995, § 38, seria A nr. 332, dhe *ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerë kundër Greqisë* [DHM], nr. 25701/94, § 89, GJEDNJ 2000-XII).

83. Për sa u përket vendimeve administrative të miratuara në çështjen e kërkesës, Gjykata vëren se vendimi i KRTT-së nuk i referohej kërkesës apo ndërtesës së tij në veçanti, por urdhëroi prishjen në përgjithësi të të gjitha ndërtimeve të paligjshme përgjatë një segmenti të caktuar të bregut të lumit Lana. Nuk kishte asnjë vlerësim në atë vendim se përse ndërtimi i kërkesës u konsiderua i paligjshëm. Për më tepër, kërkesi nuk ishte i përfshirë në procedurat që çuan në atë vendim dhe nuk kishte

mundësi të parashtronte ndonjë argument përpara miratimit të tij. Gjithashtu duket se nuk është ankimuar.

84. Pas vendimit të KRRT-së, inspektorë të Policisë së Ndërtimit mbajtën një procesverbal që kërkesi kishte kryer shkelje administrative sipas neneve 45, 66, 75 dhe 77(2) të ligjit nr. 8405, për urbanistikën. Ky procesverbal shërbeu si bazë për urdhrin e 17 shtatorit 2002 të Policisë së Ndërtimit të Tiranës për shembjen. Megjithatë, as procesverbali i policisë dhe as urdhri i shembjes nuk përmbanin ndonjë arsyetim se çfarë saktësisht përbënte shkelje administrative. Duket gjithashtu se kërkesi nuk ishte në gjendje të paraqiste asnjë argument përpara se të mbahej procesverbali dhe të lëshohej urdhri i shembjes. Ai kishte vetëm opsionin të paraqiste ankim te drejtuesi i Policisë së Ndërtimit, gjë që e bëri. Megjithatë, urdhri i shembjes u ekzekutua më 19 shtator 2002, përpara se drejtuesi i Policisë së Ndërtimit të jepte vendimin e tij mbi ankimin e kërkesës kundër tij.

85. Gjithashtu, edhe pse Gjykata e Rrethit Tiranë ka nxjerrë masën e sigurimit për pezullimin e urdhrin të shembjes po atë ditë, shembja u realizua.

86. Më pas, kërkesi kërkoi kompensim në gjykatat e brendshme për shembjen e objektit të tij. Për sa u përket vendimeve të miratuara në këto procese civile, Gjykata vëren se kërkesa e kërkesës për kompensim u rrëzua përfundimisht, sepse gjykatat e brendshme gjetën që ndërtimi i objektit nga kërkesi kishte qenë i paligjshëm për arsyet e mëposhtme: kërkesi nuk kishte fituar pronësinë e truallit në fjalë në përputhje me ligjin, sepse e vetmja provë që ai kishte paraqitur në këtë drejtim ishte një faturë; ai nuk kishte respektuar afatin kohor për ndërtimin e objektit: periudha përkatëse kishte mbaruar më 1 dhjetor 1992, por kërkesi e kishte regjistruar objektin vetëm më 16 gusht 1997; kërkesi kishte ndryshuar qëllimin e objektit sepse ai e kishte përdorur atë edhe për aktivitete tregtare; dhe leja origjinale ishte dhënë vetëm për një vit, por kërkesi nuk kishte kërkuar rinovimin e saj më pas.

87. Pa vënë në pikëpyetje gjetjen e gjykatave të brendshme që objekti i kërkesës ishte i paligjshëm, Gjykata nuk mund të mos gjente që autoritetet e brendshme nuk kishin marrë parasysh siç duhej rrethanat e mëposhtme.

88. Gjykata vëren se në periudhën përkatëse, lejet për ndërtimin e objekteve në Shqipëri janë dhënë në dy faza. Në të parën, një ose më shumë parcela toke



caktoheshin për një qëllim të caktuar dhe në të dytën jepej leja e ndërtimit.

89. Në këtë çështje, autorizimi kolektiv i dhënë më 10 dhjetor 1991 (shihni paragrafin 5 më lart) nuk përfshinte asnjë referencë të emrit të kërkuarit dhe as nuk i caktonte atij ndonjë parcelë për zhvillim. Ai autorizim caktonte parcela për ndërtim të përkohshëm të kioskave të ndryshme tregtare për biznese të vogla, tezga ushqimore, si dhe garazhe. Edhe pse emri i kërkuarit nuk ishte përfshirë në atë autorizim origjinal, Seksioni i Urbanistikës i Komitetit Ekzekutiv, supozohet duke u mbështetur në autorizimin e 10 dhjetorit 1991, i dha kërkuarit një leje ndërtimi për një objekt banimi me sipërfaqe 115.5 metër katrorë për kat. (gjithsej 462 metër katrorë). Lejen e dytë e ka lëshuar organi përkatës. Nuk i takon Gjykatës të vlerësojë se si ka ndodhur kjo dhe gjykatat kombëtare nuk e kanë kundërshtuar vlefshmërinë e saj si të tillë.

90. Për sa i përket lejes së dytë, Gjykata vëren se ajo përmbante dy kushte. Së pari, objekti duhej të përfundonte brenda gjashtë muajve dhe së dyti, objekti do të mbahej për një vit, periudhë pas së cilës kërkuari me sa duket duhej të kërkonte një leje të re për përdorimin e saj.

91. Gjykata vëren se duket që kërkuari nuk e ka përfunduar objektin brenda afatit të caktuar dhe që ai nuk ka kërkuar rinovimin e lejes pas vitit të parë. Megjithatë, kërkuari vazhdoi të përdorte ndërtesën për shumë vite pa pengesë.

92. Pas një kërke të kërkuarit, Gjykata e Rrethit Tiranë ka pranuar si fakt juridik ekzistencën e objektit dhe më pas kërkuari e ka regjistruar objektin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe i është dhënë certifikata e pronësisë. I takonte autoriteteve kombëtare kompetente, dhe veçanërisht Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të verifikonin nëse kërkuari i përmbushte të gjitha kushtet përpara se të ndërtesa në fjalë të regjistrohej në pronësi të tij.

93. Gjykata vëren gjithashtu se nuk ka asnjë tregues që kërkuari nuk ka vepruar në mirëbesim; fakti që leja e parë nuk përmbante një autorizim në emër të tij nuk mjafton në vetvete për të provuar të kundërtën. Në fakt, gjykatat e brendshme nuk provuan kurrë se kërkuari kishte vepruar në keqbesim ose që ai kishte vepruar përndryshe në mënyrë të paligjshme kur kishte marrë lejet përkatëse (krahasoni *Gavrilova dhe të tjerë kundër Rusisë*,

nr. 2625/17, § 83, 16 mars 2021, dhe *Ibrahimbeyov dhe të tjerë*, cituar më lart, § 51).

94. Nga kjo rrjedh se nëse ndonjë veprim ose mosveprim i autoriteteve vendase në lidhje me objektin e kërkuarit – si p.sh. nxjerrja e lejes së ndërtimit, lejimi i përdorimit të saj për shumë vite dhe regjistrimi i pronësisë së kërkuarit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme – do të ishte rezultat i një gabimi ose interpretimi të gabuar të ligjit, do të ishte joproporcionale që e gjithë barra e çdo pasoje të tillë të gabimeve t'i lihej vetëm kërkuarit.

95. Në këtë drejtim, Gjykata thekson rëndësinë e veçantë të parimit të qeverisjes së mirë. Ky parim, si rregull i përgjithshëm, nuk duhet t'i pengojë autoritetet të korrigjojnë gabimet e rastit, madje edhe ato që vijnë nga pakujdesia e tyre. Megjithatë, nevoja për të korrigjuar një “gabim” të vjetër nuk duhet të ndërhyjë në mënyrë disproporcionale në një të drejtë të re që është fituar nga një individ duke u mbështetur në legjitimitetin e veprimit të autoritetit publik në mirëbesim. Rreziku i çdo gabimi të bërë nga autoriteti shtetëror duhet të përballohet nga vetë shteti dhe gabimet nuk duhet të korrigjohen në kurriz të individëve në fjalë. Në kontekstin e revokimit të pronësisë së një prone të fituar gabimisht, parimi i qeverisjes së mirë jo vetëm që mund t'u imponojë autoriteteve një detyrim për të vepruar menjëherë në korrigjimin e gabimit të tyre, por gjithashtu mund të kërkojë pagesën e kompensimit të duhur ose një lloj tjetër dëmshpërblimi të duhur për mbajtësin e mëparshëm *bona fide* (shihni *Beinarovič dhe të tjerë kundër Lituanisë*, nr. 70520/10 dhe 2 të tjerë, §§ 139–40, 12 qershor 2018, me referenca të mëtejshme).

96. Në të njëjtën kohë, Gjykata merr parasysh gjetjet e gjykatave kombëtare që kërkuari e kishte përdorur objektin si një vend biznesi edhe pse kishte marrë leje ndërtimi vetëm për një objekt banimi dhe që ai nuk kishte kërkuar rinovimin e lejes, siç kërkohej.

97. Në funksion të këtyre gjetjeve, Gjykata vlerëson se barra për krijimin e rrethanave që çuan në shembjen e objektit të kërkuarit duhej të ishte shpërndarë mes autoriteteve të brendshme dhe kërkuarit. Meqë kërkuari kishte vepruar në mirëbesim, kishte marrë një leje për një objekt banimi, kishte regjistruar pronësinë e tij dhe ishte lejuar për shumë vite pa asnjë pengesë që të përdorte objektin në fjalë, Gjykata vlerëson se kërkuari ishte



orientuar të besonte se pronësia e tij mbi objektin në fjalë ishte legjitime, dhe për këtë arsye duhej të ishte dhënë një kompensim për shembjen e saj.

98. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se një person i privuar nga prona e tij duhet në parim të marrë kompensim “të lidhur në mënyrë të arsyeshme me vlerën e tij”, edhe pse “objektivat legjitime të “interetit publik” mund të kërkojnë më pak se rimbursimin e vlerës së plotë të tregut”. Nga kjo rrjedh se ekuilibri i përmendur më sipër arrihet përgjithësisht kur kompensimi që i paguhet personit të cilit i është marrë prona lidhet në mënyrë të arsyeshme me vlerën e tij “të tregut”, siç përcaktohet në kohën e shpronësimit (shihni *Pincová dhe Pinc kundër Republikës Çeke* nr. 36548/97, § 53, GJEDNJ 2002-VIII).

99. Në këtë çështje, Gjykata vëren se është rrëzuar pretendimi i kërkuarit për kompensim.

100. Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata konstaton se ndërhyrja në të drejtat pronësore të kërkuarit në rrethanat e veçanta të çështjes në fjalë nuk arriti të vendoste një ekuilibër të drejtë mes interesit publik dhe të drejtave të kërkuarit sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

101. Prandaj konstatohet shkelje e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

102. Nisur nga ky përfundim, nuk është e nevojshme të trajtohet ankimi i kërkuarit për objektin e tij të shembur në kundërshtim me masën e sigurimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

103. Më tej kërkuari u ankua sipas nenit 8 të Konventës që shembja e objektit të tij përbënte shkelje të së drejtës së tij për respektimin e banesës së tij, sepse ai dhe familja e tij kishin jetuar në atë ndërtesë, pa konfirmim të mëtijshëm për ndonjë vështirësi në gjetjen e strehimit alternativ.

104. Gjykata konstaton se ky ankim është i lidhur ngushtë me ankimin sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës dhe prandaj vlerëson se, nisur nga gjetjet e saj sipas nenit 1 të protokollit nr. 1, nuk ka nevojë të shqyrtojë veçmas pranueshmërinë ose themelin e ankimit sipas nenit 8 të Konventës.

V. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

105. Në fund, kërkuari u ankua sipas nenit 13 të Konventës që ai nuk kishte pasur zgjidhje efektive

për ankimet e tij në lidhje me shembjen e objektit të tij.

106. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkuari mund të ankohej për vendimin e KRTT-së të drejtuesi i Policisë së Ndërtimit, si edhe ta kundërshtonte atë para gjykatave. Fakti që përpjekjet e tij ishin përfundimisht të pasuksesshme nuk ndikon në disponueshmërinë e këtyre mjeteve juridike pasi neni 13 nuk garanton suksesin e një mjeti juridik që është ndjekur.

107. Prandaj, ky ankim është qartazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

VI. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

108. Neni 41 i Konventës lexon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

A. Dëmi

1. Dëmi pasuror

109. Kërkuari pretendoi 4.789.205,25 euro (EUR) si dëm pasuror për vlerën e truallit dhe objektit në fjalë.

110. Qeveria parashtroi që shumat e pretenduara janë të pabazuara dhe të tepruara.

111. Gjykata vëren së pari se gjykatat kombëtare konstatuan se kërkuari nuk kishte qenë pronar i truallit ku ishte ndërtuar objekti dhe Gjykata nuk sheh asnjë arsye për ta vënë në dyshim këtë përfundim. Për sa i përket vetë objektit, Gjykata vëren se leja që i ishte dhënë kërkuarit i referohej vetëm qëllimeve të banimit. Megjithatë, sipas raportit të dorëzuar nga kërkuari, vetëm kati i dytë i objektit me sipërfaqe 118,72 metra katrorë dhe papafingo me sipërfaqe 93,75 metra katrorë, janë përdorur për banim, ndërsa pjesët e tjera të objektit janë përdorur për biznes, në kundërshtim me qëllimi për të cilin ishte lëshuar leja.

Gjithashtu kërkuari nuk ka kërkuar rinovimin e lejes, siç kërkohej. Nisur nga këto rrethana dhe barra e përbashkët e situatës që çoi në shembjen e banesës së kërkuarit, Gjykata vlerëson se kërkuarit duhet t'i jepet shuma prej 50,000 euro për dëmin pasuror.

2. Dëmi jo pasuror

112. Kërkuari pretendoi 250,000 EUR për dëmin jopasuror.



113. Qeveria parashtroi që shumat e pretenduara janë të pabazuara dhe të tepruara.

114. Gjykata vlerëson se kërkuuesi pa dyshim ka qenë i shqetësuar dhe i zhgënjyer për shkak të shembjes së objektit të tij. Megjithatë, ajo e konsideron të tepërt shumën e kërkuar. Duke e bërë vlerësimin e saj mbi një bazë të drejtë dhe duke marrë parasysh gjetjet e saj në këtë vendim, Gjykata i cakton kërkuessit shumën 3,000 euro në lidhje me dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet.

B. Kosto dhe shpenzime

115. Gjithashtu kërkuuesi pretendon 7,000 euro për kosto dhe shpenzime të bëra para gjykatave të brendshme dhe Gjykatës.

116. Qeveria parashtroi se shumat e pretenduara ishin të tepruara dhe se faturat e ofruara nuk ishin dorëzuar sipas formularëve të faturave të miratuar formalisht.

117. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, një kërkuess ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për atë që provohet se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme sa i përket shumës. Në këtë çështje, Gjykata vëren se kërkuuesi ndoqi proceset përpara katër shkallëve të gjykatave të brendshme përpara se të paraqiste kërkesën e tij në Gjykatë. Gjykata ka hedhur poshtë më parë argumente të ngjashme nga Qeveria se pretendimet për kostot dhe shpenzimet duhet të mbështeten në fatura të miratuara zyrtarisht (shihni *Sharxhi dhe të tjerë*, cituar më lart, § 209; *Delijorgji kundër Shqipërisë*, nr. 6858/11, § 100, 28 prill 2015; *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, § 129, 1 prill 2014; dhe *Hysa kundër Shqipërisë*, nr. 52048/16, § 93, 21 shkurt 2023). Gjykata nuk sheh arsye për të arritur në një konkluzion të ndryshëm në këtë çështje.

118. Duke pasur parasysh dokumentet përpara saj dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që t'i caktojë kërkuessit shumën prej 7000 EUR për të mbuluar shpenzimet nën çdo zë, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *shpall* të pranueshëm ankimin sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe ankimin sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës dhe të papranueshëm ankimin sipas nenit 13 të Konventës;

2. *vendos* që nuk ka shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës;

3. *vendos* që është shkelur neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës;

4. *vendos* që nuk ka nevojë të shqyrtojë pranueshmërinë ose themelin e ankimit sipas nenit 8 të Konventës;

5. *vendos*

a) që Shteti i paditur t'i paguajë kërkuessit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 44 të Konventës, shumat e mëposhtme që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

i) 50000 euro (pesëdhjetë mijë euro) për dëmin pasuror, plus çdo taksë që mund të ngarkohet;

ii) 3000 euro (tre mijë euro) për dëmin jo pasuror, plus çdo taksë që mund të ngarkohet;

iii) 7000 (shtatë mijë euro) për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuessit;

b) nga mbarimi i afatit tre mujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;

6. *mërzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuessit për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 11 qershor 2024 sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
Kancelar

Jolien Schukking
President

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

